




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË



Nr. 1012 Prot.

Vlorë, më 07/04/2026

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i Kontabilizimit)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Departamentit Ekonomik dhe Burimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Aseteve dhe Burimeve Mbështetëse

Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit Help Desk

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të dy akteve administrativ – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore (bashkëngjitur) si vijon :

- Nr.23, me Nr.98/5 Prot., datë 09/03/2026, i materializuar për subjektin “Erlinda Hasanaj” lindur dhe banues në Vlorë.
- Nr.27, me Nr.706/2 Prot., datë 24/03/2026, i materializuar për subjektin “Coffeeshouse” sh.p.k, me NUIS L82106034R, me administrator znj. Eralda Murataj, me seli në Tiranë (Kamëz; Njësia Administrative Bërxullë, Rruga Ardhmëria, Nr.Pasurie 120/9, Z.Kadastrale 1167, Kapanon 1 kat);

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 98/5 Prot.

Vlorë, më 09/03/2026

V E N D I M Nr.23

Sot, më datë 09/03/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova materialin e plotë (bashkëngjitur), i mbajtur në ngarkim të subjektit “**Erlind Hasanaj**” p.f me NID J50416050D, i lindur dhe banues në Vlorë,

K O N S T A T O V A S E :

Më datën 08/01/2026, nga ana e Policisë Kufitare dhe Migracionit Vlorë në bashkëpunim me Degën e Doganës Vlorë, është ushtruar kontroll në vijën e dytë të zonës doganore/kufitare. Gjatë kontrollit të ushtruar është konstatuar mall akcize të padeklaruara, pa pullë fiskale. Për këtë konstatim, nga ana e grupit të kontrollit janë mbajtur aktet shkresore në vijim :

- Proces Verbal “Për lënies në ruajtje të provave materiale”, administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë me nr.98 Prot., datë 09/01/2026, në të cilin, oficeri i policisë gjyqësore pranë Seksionit të Hetimit & ZMPKT, në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Vlorë ka parashtuar si vijon : “...për nevoja të procedimit penal nr.1622 viti 2025 dhe në mbështetje të K.Pr.Penale mbaj këtë procesverbal për të dokumentuar faktin e lënies në ruajtje të provave materiale, konkretisht si më poshtë vijojnë :

1.29 (njëzet e nëntë) steka me cigare të markës Winston Blue pa pullë fiskale;

Këto prova i lihen në ruajtje Degës Doganore Vlorë. Procesverbali i lënies në ruajtje përpilohet në dy kopje, njërën prej saj e merr marrësi në dorëzim i provës materiale, kurse tjetra i dorëzohet prokurorit. Procesverbali i lënies në ruajtje pasi lexohet me zë të lartë, gjendet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje”.

- Në zbatim të aktit të lartcitar, grupi i punës konkretisht, personeli doganor i autorizuar i Degës së Doganës Vlorë, procedoi me mbajtjen e akteve shkresore përkatëse, midis të tjerave Proces verbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative me numër serial 0032856, datë 09/01/2026, me Nr.98/3 Prot., datë 09/01/2026, në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes doganore si vijon : “Shtetasi shqiptar Erlind Hasanaj me nr.ID J50416050D iu sekuestruan 29 steka cigare të markës Winston Blu pa pullë fiskale. Stekat e cigareve u gjendën në automjetin e tij me targa AA050RB. Shtetasi shqiptar do të penalizohet sipas nenit 266/6 – raste të tjera kondrabanede dhe do të paguajë gjobën në masën 3 fish të detyrimit të munguar”.

Nga shqyrtimi i akteve të autoritetit doganor rezulton se konstatimi lidhet me gjetjen e mallrave të akcizës të padeklaruar, të papajisura plotësisht me pullë akcize dhe pa dokumentacion shoqërues (faturë tatimore apo dokument tjetër tregtar që provon origjinën dhe pronësinë e mallit).

Subjekti shkelës, si palë e interesuar në procedimin administrativ, rezulton se ka pasur të gjithë informacionin e duhur rreth procedimit administrativ që po zhvillohej ndaj tij, rreth shkeljes së akcizës që i atribuohet dhe pasojat ligjore që është dënuar me penaltetin përkatës në shumën e trefishit të detyrimit të fiskal (akcizës) të papaguar dhe me sekuestrimin e mallit.

Është fakt se autoriteti konstatues, i cili zotëron të drejtën t'i kërkojë subjektit të paraqesë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm, ka proceduar në rastin konkret lidhur me saktësimin dhe verifikimin e dokumentacionit të subjektit, inventarizimin e plotë të mallrave të akcizës që ishin gjendje në mjetin e transportit etj.

Subjekti shkelës, i cili ka patur detyrimin ligjor që të bindë autoritetin konstatues si dhe atë vendimmarrës, në paraqitjen e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të nevojshëm për të hequr çdo dyshim dhe për të vërtetuar me anë të dokumentacionit ligjor të drejtën e tij për ushtrimin në mënyrë korrekte transportimin e mallit “Duhan e produkte duhani”, në momentin e konstatimit, nuk i'u ka mundur autoriteteve doganore një informacion të tillë.

Konstatohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me mall akcize parashikuar në nenin 2, pika 2 dhe 3 e Ligjit nr.61/212 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” - *“Akcizë” është një taksë që zbatohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara, që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë.* Neni - 3 *“Produkte që i nënshtrohen akcizës janë : a) produktet energjetike; b) alkooli dhe pijet alkoolike; c) duhani e produktet e duhanit; ç) produktet e tjera, të përcaktuara nga ky ligj.*

Ka rezultuar se nga ana e subjektit, nuk është vepruar në përputhje me legjislacionin doganor, pasi është provuar fakti se në mjetin e tij të transportit, i është gjendur një sasi malli akcize (duhan e produkte duhani i pasqyruar në aktet e lartcituara) pa pulla fiskale, gjë e cila bie ndesh me legjislacionin doganor.

Neni 250 i Kodit Doganor i cituar si neni i shkelur : 1. *Shkelje doganore janë: a) kundërvajtjet administrative doganore; b) kontrabanda.*

– Neni 250/3 – *“Kontrabandë janë veprat penale të sanksionuara në Kodin Penal që cenojnë marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenet 266 dhe 267 të këtij Kodi.*

Neni 266 i Kodit Doganor “Raste të kontrabandës”, parashikon : *Konsiderohet kontrabandë: 2. Futja apo nxjerrja e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pa i paraqitur ato tek autoritetet doganore, sipas përcaktimeve të neneve 130, 218 ose pikës 2, të nenit 239;*

Neni 268 i Kodit Doganor “Sanksionet administrative për kontrabandën” parashikon :

1. Autoritetet doganore vendosin sekuestro të përkohshme për mallrat që janë objekt i kontrabandës, përfshirë edhe mallrat që nuk tatohen.

2. Autoritetet doganore vendosin sanksione administrative për rastet e kontrabandës në masën trefish të shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabande, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në Kodin Penal;

3. Çdo shkelës përgjigjet personalisht dhe solidarisht për pagesën e sanksionit të mësipërm, në varësi të shkallës së pjesëmarrjes. Në këtë rast, secili prej tyre është i detyruar të përmbushë tërësisht detyrimet dhe autoritetet doganore mund të kërkojnë pagesën ose të padisin njërën ose/dhe të gjitha palët.

Në përfundim, pas shqyrtimit të plotë të materialit të mësipërm, rezulton e provuar shkelja doganore “kontrabandë”, parashikuar nga Ligji nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar). Në mungesë të dokumentacionit justifikues nga subjekti dhe për shkak të natyrës së mallrave (duhan e produkte duhani), ndëshkimi me gjobë dhe sekuestrimi i mallrave janë masa ligjore të justifikuara. Nëse subjekti pretendon se malli ishte i ligjshëm apo se ndodhej aty për arsye të caktuara, ai duhet të kishte dokumentuar këtë fakt në mënyrë të saktë dhe të plotë.

Për sa më sipër, mbështetur në konkluzionet e evidentuara në Procesverbalin me nr.98/3 Prot., datë 09.01.2026, Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.61/212 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat Zbatuese të Ligjit “Për Akcizat”, Ligjin nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH” të ndryshuar, V.K.M–në nr.651 datë 10.11.2017 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014”,

V E N D O S A :

- Subjektit “**Erlind Hasanaj**” p.f me NID J50416050D, t'i sekuestrohet menjëherë malli i pasqyruar në aktet e lartpërmendura, bazuar në nenin 268/1 të Ligjit nr.102/2014 datë 31.07.2014.
- Subjekti “**Erlind Hasanaj**” p.f me NID J50416050D, të ndëshkohet me gjobë në masën e trefishit të detyrimit fiskal të papaguar, në shumën **150,000** (Njëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 268/2 të Ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.706/2 Prot.

Vlorë, më 24/03/2026

VENDIM Nr. 27

Sot, më datë 24/03/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0032810, nr.706 Prot., datë 06.03.2026, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Coffeehouse” sh.p.k, me NUIS L82106034R, me administrator znj. Eralda Murataj, me seli në Tiranë (Kamëz, Njësia Administrative Bërxullë, Rruga Ardhmëria, Nr.Pasurie 120/9, Z.Kadastrale 1167, Kapanon 1 kat); adresa elektronike coffee.house.albania@gmail.com; si dhe praktikat doganore,

KONSTATOVA SE:

Pranë Degës Doganore Vlorë rezulton se subjekti “Coffeehouse” sh.p.k., me NUIS L82106034R, i përfaqësuar nga agjencia doganore “Gad Universi”, me kod përfaqësimi J102, ka proceduar me deklarimin e mallrave nëpërmjet deklaratave doganore të regjimit IM4, konkretisht: R 11990, datë 31.08.2025; R 12856, datë 18.09.2025; R 10530, datë 22.07.2025; R 9676, datë 06.07.2025.

Nga shqyrtimi i këtyre deklaratave rezulton se mallrat e deklaruar janë trajtuar me tarifë preferenciale (taksa doganore 0%), si pasojë e vendosjes në kutinë 36 të DAV-it të kodit MSABE, duke përfituar në mënyrë të padrejtë lehtësime tarifore. Ndërkohë, sipas klasifikimit tarifor përkatës (kod tarifor 3920), mallrat në fjalë i nënshtrohen një takse doganore bazë prej 6%.

Origjina preferenciale e mallrave nuk mund të njihet, pasi dokumentacioni shoqërues nuk përmban prova të vlefshme të origjinës, konkretisht mungon certifikata EUR.1 ose një deklaratë faturë e rregullt dhe e plotë sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu, subjekti nuk rezulton të jetë eksportues i miratuar, çka përjashton mundësinë e përdorimit të deklaratës në faturë për vlera mbi kufirin e lejuar. Për më tepër, për faturat me vlerë mbi 6,000 euro kërkohet pajisja me certifikatë EUR.1.

Në vijim të verifikimeve, është ushtruar kontroll mbi deklaratat doganore të sipërcituara, në përfundim të të cilit grupi i kontrollit ka hartuar Procesverbalin e shkeljes doganore me nr. serial 0032810, nr. 706 Prot., datë 06.03.2026, ku është konstatuar se: “Gjatë verifikimit të deklaratave me nr. R 11990, datë 31.08.2025; R 12856, datë 18.09.2025; R 10530, datë 22.07.2025; R 9676, datë 06.07.2025, u konstatua se malli i deklaruar ‘bobina qeska për ambalazhim kafeje’ është deklaruar me origjinë preferenciale MSABE, duke përfituar padrejtësisht nga tarifa doganore 0%, ndërkohë që nuk plotëson kushtet për përfitimin e origjinës preferenciale. Për faturat me vlerë mbi 6,000 euro kërkohet pajisja me certifikatë EUR.1”.

Procesverbali i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 706/1 Prot., datë 09.03.2026, me lëndë “Njoftim i procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”, si dhe nëpërmjet postës elektronike në datën 19.03.2026, me lëndë “Rinjofitim i procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”.

Dega Doganore Vlorë, pas shqyrtimit të deklaratave doganore, dokumentacionit shoqërues të depozituar në sistem, si dhe të të gjitha burimeve të informacionit në dispozicion, vlerëson se origjina preferenciale u njihet

vetëm mallrave që plotësojnë kriteret e përcaktuara në legjislacionin doganor dhe në marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse. Këto përfitime tarifore aplikohen vetëm në rastet kur mallrat tregtohen ndërmjet vendeve që kanë marrëveshje preferenciale dhe kur plotësohen kushtet përkatëse të origjinës.

Kriteret për përfitimin e statusit origjinues kërkojnë që mallrat të jenë tërësisht të përfituara ose të përpunuara në masë të mjaftueshme në vendin përfitues. Në mungesë të këtyre kushteve, mallrat nuk mund të konsiderohen si “origjinuese” dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfitojnë trajtim tarifor preferencial.

Dokumentacioni që provon origjinën preferenciale të mallrave përfshin:

- a) Certifikatat e qarkullimit EUR.1, EUR.1 (CEFTA), EUR-MED;
- b) Deklaratën në faturë, deklaratën në faturë (CEFTA), si dhe deklaratën e origjinës EUR-MED.

Certifikata EUR.1 është një dokument zyrtar që lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues, mbi bazën e një aplikimi të eksportuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar. Ndërsa deklaratat në faturë duhet të përmbajë tekstin standard të parashikuar në legjislacion dhe të jetë e plotësuar në përputhje me kërkesat formale, përfshirë firmën dhe identifikimin e qartë të eksportuesit.

Në rastin konkret, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm që provon origjinën preferenciale të mallrave. Për rrjedhojë, përfitimi i trajtimit preferencial rezulton i pabazuar në ligj dhe në fakte.

Si pasojë, mallrat objekt deklarimi duhet të rivlerësohen dhe të trajtohen me taksën doganore bazë prej 6%, duke rikuperuar detyrimet doganore të shmangura.

Autoriteti vendimmarrës i Degës së Doganës Vlorë, vlerëson se :

Në mungesë të dokumentacionit provues për origjinën preferenciale, përfitimi i trajtimit tarifor preferencial është i pabazuar në ligj;

Mallrat objekt deklarimi nuk përmbushin kriteret për t’u konsideruar me origjinë preferenciale dhe, për rrjedhojë, duhet të trajtohen me taksën doganore bazë.

Veprimet e kryera kanë sjellë shmangie të detyrimeve doganore në dëm të buxhetit të shtetit.

Në mbështetje të sa më sipër, dhe në referim të bazës ligjore përkatëse, konkretisht Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenet 6, pika 18 dhe 20, si dhe nenet 23, 49, 72/3, 250/1/a, 251/1/2/a, 256/1/a, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, vlerësohet se rivlerësimi i mallrave dhe aplikimi i detyrimeve doganore është i ligjshëm dhe i detyrueshëm për zbatim.

V E N D O S A :

• Rivlerësimin e mallrave të deklaruara në deklaratat doganore IM.4 si vijon : R 11990, datë 31.08.2025; R 12856, datë 18.09.2025; R 10530, datë 22.07.2025; R 9676, datë 06.07.2025 – si rrjedhim, subjekti “Coffeehouse” sh.p.k, me NUIS L82106034R të paguajë detyrimin doganor në shumën 255,798 (dyqind e pesëdhjet e pesëmijë e shtatëdhjet e tetë) lekë.

- Subjekti “**Coffeehouse**” sh.p.k, me NUIS L82106034R, të penalizohet me masë administrative gjobë në masën e njëfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 255,798 (dyqind e pesëdhjet e pesëmijë e shtatëqind e nëntëdhjet e tetë) lekë.
- Për të proceduar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi ngarkohen Zyra e Kontrollit Aposterior, Zyra e Financës, Zyra e Borxhit Doganor, këtu.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “**Coffeehouse**” sh.p.k, me NUIS L82106034R, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30(tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj

